



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.18, datë 16.01.2023

PËR

“CAKTIMIN E ZOTIT GAZMEND FRËNGU NË DETYRËN E PROKURORIT
NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
GJIROKASTËR, NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës, nenet 41 dhe 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 44 dhe 45 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin e zotit Gazmend Frëngu në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, shpallur me vendimin Nr.299, datë 10.11.2022.
2. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Gazmend Frëngu, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë.
3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 28.02.2023, dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 16.01.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Mirela Bogdan

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Arta Mandro

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza